



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVO CUMHURIYETI**

C.nr.457/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Majlinda Shala, në kontestin e paditësit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a. - Prishtinë, kundër të paditurit M.H nga Prizreni, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 90.56 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 22.12.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Posta dhe Telekomuni i Kosovës - Prishtinë dhe **detyrohet** i padituri M.H nga Prizreni, që paditësit në emër të borxhit për shfrytëzimin e telefonisë fikse t'ia paguajë shumën e të hollave në vlerë prej **90.56** euro, me kamatë ligjore sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke iu llogaritur prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Tani paditësi (ish kreditori) Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a. - Prishtinë, me datën 16.09.2009, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit autentik, kundër babait të të paditurit (ish debitorit) A.H nga Prizreni, për shkak të pagesës së borxhit. Me datën 18.09.2009, gjykata ka marr aktvendimin E.nr.1771/09, për caktimin e përmbarimit të propozuar.

Kundër Aktvendimit për përmbarim E.nr.1771/09, të datës 18.09.2009, djali i ish debitorit, këtu i padituri M.H kishte parashtruar kundërshtim, duke e atakuar të njëjtin me arsyetimin se babai i tij (debitori) A.H ka vdekur me datë 11.12.2001nuk mund të paguajë borxhin pasi që jeton me ndihma sociale, me propozim që kundërshtimi i tij të aprovohet dhe që aktvendimi i atakuar të lihet jashtë fuqie, si dhe duke propozuar pezullimin e ekzekutimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr. 1771/09, të datës 18.09.2009.

Duke vendosur sipas kundërshtimit të të paditurit (ish debitorit), me datën 19.01.2012, kjo gjykatë në procedurë përmbarimore ka marrë konkluzion përmes të cilit është shfuqizuar aktvendimi për lejim të përmbarimit E.nr. 1771/09, të datës 18.09.2009, ndërsa që propozimi për ekzekutim i kreditorit, është konsideruar padi.

Në procedurën kontestimore, gjykata me aktvendiminn C:nr.89/12, të datës 30.01.2012, e ka ndërpreë procedurën për shkak të vdekjes së palës së paditur (ish debitorit) A.H nga Prizreni. Me propozimin e palës paditëse të datës 06.02.2012, është kërkuar vazhdimi i procedurës, ku si palë të paditur e kanë caktuar M.H, pasi që kanë konstatuar se i njejtë e shfrytëzon këtë telefon.

Seanca e shqyrtimit kryesor për këtë çështje juridiko kontestimore është mbajtur me datë 23.12.2014, si dhe procedura është zhvilluar në zbatim të neneve 484 dhe 485, që kanë të bëjnë me procedurën me kontestet me vlerë të vogël.

Në këtë seancën e shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditësit S.Th ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta obligojë të paditurin që në emër të borxhit, t'ia paguajë paditësit shumën në lartësi prej 90.56 eurove me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës për të cilat nuk është specifikuar.

I padituri M.H në seancën e shqyrtimit kryesor nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, mirëpo ka theksuar se është i gjendjes së dobët ekonomike, pasi që është shfrytëzues i ndihmës juridike, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare i ka propozuar gjykatës, refuzimin e kërkesëpadisë, pasi që është i gjendjes së varfër ekonomike dhe nuk ka mundësi të pagesës. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat e propozuara si në vijim: faturat për muajt: Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2008 si dhe faturat për muajt: Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor 2009.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar**.

Nga leximi i faturave për muajt: Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2008 si dhe faturave për muajt: Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor 2009, gjykata ka konstatuar se të njëjtat janë lëshuar në emër të paraardhësit të të paditurit M.H, si dhe borxhi i përgjithshëm në bazë të këtyre faturave është në shumën prej 90.46 €.

Me nenin 17 Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është e paraparë se *“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se *“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Poashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se *“ palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat*

konstatohen faktet e tilla”, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se “Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)...”.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, është provuar se këtu i padituri M.H nga Prizreni, ka detyrime-borxh, ndaj paditësit Posta dhe Telekom i Kosovës sh.a. - Prishtinë për periudhën kontestuese, shumën e cekur në kërkesëpadi, pasi që i njëjti pas vdekjes së babait A.H ish nga Prizreni, ka jetuar në adresën e njëjtë dhe e ka shfrytëzuar numrin e telefonit të lartcekur dhe ka shkaktuar borxhin ndaj këtu paditësit. Në bazë të provave të administruara del se ky borxh evidentohet në emër të paraardhësit të këtu të paditurit M.H nga Prizreni. Andaj, duke u bazuar në gjendjen e këtyllë faktike të vërtetuar, dhe pasi që i padituri nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit për nga lartësia apo për ndonjë shkak tjetër mirëpo të njëjtën e ka kundërshtuar vetëm për shkak të pamundësisë së pagesës së borxhit, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditësit duhet të aprovet në tërësi si e bazuar.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kumatën vjetore, gjykata vendosi konform nenit 186 lidhur me nenin 277 par.1 të LMD-së, pasi që i padituri është vonuar në pagesën e detyrimit ndaj paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së, pasi që i autorizuari i paditësit i ka kërkuar shpenzimet por nuk i ka specifikuar, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.457/12, datë 22.12.2014

Sekretarja juridike
Majlinda Shala

Gjyqtari
Arsim Hamzaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

Aktgjykimi mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale